Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve të Aplikuara**
Titulli i lëndës:	**Përgatitje për shtyp**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**3**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**5**
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë trajtohen llojet e printimit (komercial, digjital dhe offset), softuerët aplikativë për shtyp, modelet e ngjyrave, fotografitë raster dhe vektoriale, rezolucioni, si dhe formatet e dokumenteve për shtyp. Studentët zhvillojnë aftësi në përgatitjen e dizajnit grafik dhe tekstit për shtyp profesional dhe në vlerësimin nëse rezultati i printuar përputhet me kërkesat e tyre dhe të klientit. Lënda fokusohet në përgatitjen teknike të materialeve grafike për shtyp profesional. Studentët mësojnë menaxhimin e ngjyrave (CMYK), rezolucionin, bleed, crop marks, formatet PDF/X, kontrollin preflight dhe procesin e prodhimit në shtypshkronjë. Lënda kombinon teorinë e prodhimit grafik me praktikë konkrete në përgatitjen e skedarëve për print industrial.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është zhvillimi i aftësive teknike për përgatitjen e materialeve për shtyp, kuptimi i procesit të prodhimit në shtypshkronjë, dhe sigurimi i standardit profesional në eksportimin e dokumenteve për print.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studenti do të jetë në gjendje të: • Njohë parimet e projektimit sipas standardeve të shtypit profesional.

	• Analizojë mostrën që kërkohet të përgatitet për shtyp dhe të menaxhojë ngjyrat dhe profilet ICC. • Kuptojë, kontrollojë dhe korrigjojë gabimet përmes preflight. • Zbatojë parimet dhe teknikat e shtypit profesional për eksportimin e skedarëve.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë	2	12	24
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14	28
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet, etj	4	6	24
Totali			**125**

Metodologjia e mësimëdhënies:	Ligjërata, punë individuale, realizimi i punës praktike, detyra, diskutime, punë në grupe dhe mësimdhënie e bazuar në projekte (project-based learning).
Metodat e vlerësimit:	80% Punime Praktike 20% Prezantim

Literatura	**Literatura**
Literatura bazë:	Sandee Cohen, From Design Into Print: Preparing Graphics and Text for Professional Printing, 1st Edition, Peachpit Press, 2005.
Literatura shtesë:	Alan Pipes, Production for Graphic Designers, 6th Edition, Laurence King Publishing, 2016.
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	**Ligjerata që do të zhvillohet**
Java e parë:	***Hyrje në procesin e shtypit***
Java e dytë:	***Modelet e ngjyrave (RGB vs CMYK)***
***Java e tretë*:**	***Rezolucioni dhe DPI***
Java e katërt:	***"Bleed", "Margins" dhe "Crop Marks"***
Java e pestë:	***Profilet ICC dhe menaxhimi i ngjyrave***
***Java e gjashtë*:**	***Formate të shtypit dhe madhësitë standarde***
Java e shtatë:	***Preflight dhe kontroll teknik***
Java e tetë:	***PDF/X standardet***
Java e nëntë:	***Eksportimi i skedarëve për shtyp dhe automatizimi i rrjedhës së punës (batch processing)***
Java e dhjetë:	***Tipografi për shtyp***
***Java e njëmbedhjetë*:**	***Llojet e letrës dhe materialeve***
***Java e dymbëdhjetë*:**	***Teknikat e printimit (offset, digital, large format)***
***Java e trembëdhjetë*:**	***Kontroll cilësor dhe prova e shtypit***
***Java e katërmbëdhjetë*:**	***Vizitë në shtypshkronjë / simulim praktik***
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	***Projekt final dhe prezantim***
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.	